

STATUTI I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“OLEA TRADE” sh.p.k.

Në bazë të ligjit nr.9901.dt.14/04/2008. “ Për Shoqëritë Tregëtare

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

THEMELIMI, EMRI

Sot më dt.01/09/2023 në Lagjen 28 Nentori, te qytetit te ELBASANIT themelohet Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “OLEA TRADE “ sh.p.k. formuar në bazë të Aktit të Themelimit e firmosur nga Ortaku themelues:

- Antonio Paolo Malerba, nenshtetas Italian i datelindjes 05/03/1988 ne Bari (ITALI) i identifikuar me leternjoftim Nr. CA03319BR

Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2

OBJEKTI

Shoqëria “OLEA TRADE” sh.p.k.do të ketë si objekt të aktivitetit të saj tregëtar si më poshtë : “Kryerja e aktivitetit ne fushen e ndermjetesimit tregëtar (broker/komisioneri) per gjetjen e tregjeve brenda dhe jashte vendit per produkte ushqimore , industriale dhe te sherbimeve te ndryshme. Te blejë e te shesë ose te japë me qira, ne përdorim, ne uzufrukt, ose ne shfrytëzim pasuri te luajtshme e pasuri te paluajtshme e te regjistruara ne regjistrat publike.(agjensi imobiliare)

-Shoqëria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregëtare, mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, qe do te vlerësohen te nevojshme apo te dobishme për realizimin e objektit te shoqërisë si dhe te blejë pjesëmarrje ne kapitalin themeltar te shoqërive te tjera qe kane objekt te ngjashëm apo te afërt me te vetin.

-Shoqëria mund te ketë pjesëmarrje ne formën e mbajtjes se aksioneve/kuotave apo interesave te tjera ne shoqëri tregëtare apo ndërmarrje me objekt veprimtarie te çfarëdo lloji, ashtu sikur se do te ofroje dhe japë garanci te gjitha formave ligjore për sigurimin e përmbushjes se detyrave të të tretëve, gjithashtu mund të kryeje të gjitha veprimet e nevojshme të vendimmarrjes dhe administrimit të shoqërive apo ndërmarrjeve ne të cilat merr pjese ne cilësinë e ortakut apo aksionerit si dhe do të kryeje çdo veprimtari tjetër të natyrës financiare e tregëtare për përmbushjen e objektit të veprimtarisë se shoqërisë, ne përputhje me Ligjin Shqiptar.

Për të arritur qëllimin e shoqërisë, kompania do të jetë në gjendje të kryejë të gjitha operacionet



tregtare, industriale dhe të pasurive të paluajtshme dhe gjithashtu do të jetë në gjendje të kryejë, në baza jo të përhapura dhe tërësisht ndihmëse dhe instrumentale dhe në çdo rast me shprehim përjashtimin e çdo veprimtarie të kryer me publikun, letrat me vlerë, garancitë e granteve, miratimet, garancitë, garancitë edhe në favor të palëve të treta, si dhe të marrin përsipër, vetëm për qëllime investimi të përhershëm dhe jo për vendosje, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, aksione në shoqëri italiane dhe të huaja që kanë një objekt të ngjashëm të lidhur ose të lidhur me të vetat. Tregtimin dhe perpunimin e produkteve agroushqimore dhe nenprodukteve të tij.”

Neni 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë me afat të papercaktuar kohor. Nderprerja e aktivitetit të shoqërisë bëhet me një vendim të asamblese së ortakëve/ortakut. Personalitetin juridik Shoqëria e fiton nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar në Q.K.B. , date e cila do të shenojë dhe fillimin e veprimtarisë së saj.

Neni 4

VENDNDODHJA E SHOQËRISE

Selia e shoqërisë do të jetë:

“Lagjja 28 Nentori, autostrada Elbasan-Metalurgji km-1, ndërtesa nr.2, kati 1, qyteti i ELBASANIT”.

Shoqëria mund të hapë filiale, përfaqësi, axhensi të tjera në çdo qytet Brënda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU II KAPITALI

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar aksioner i shoqërisë "OLEA TRADE" sh.p.k. është 1,000 lekë (një mijë lekë) i cili nuk është paguar.

Pjesëmarrja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë dhe është në përpjesëtim me kontributin e tij siç tregohet më poshtë:

Ortaku themelues ANTONIO MALERBA si ortak i kësaj shoqërie zotëron 1 kuotë me një vlerë totale prej 1,000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT



Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet Asamblesë së Ortakëve/Ortakut te vetëm.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve/Ortakut të vetëm, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit në kapitalin e shoqërisë;

shitblerjes;

trashëgimisë;

dhurimit;

çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nga Ortaku i kesaj shoqërie, tek te tretet qe nuk jane pjese e Shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

ORGANI VENDIMARRRES

Asambleja e Ortakëve/Ortakut të vetëm eshte organi i vetem vendim marres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve/Ortakut të vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;



- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

ADMINISTRIMI

Asambleja e përgjithshme e ortakeve/Ortaku i vetëm emëron një person fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje . Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator emerohet z.ANTONIO MALERBA afati kohor i administratorit është nga data 01.09.2023 deri ne datë 01.09.2028.

Neni 13

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakeve;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme të ortakeve për miratim;
- d) krijojë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme të ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar te therasë Asamblene e Pergjitheshme të Ortakëve, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të asete e të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.



Nëse asambleja e përgjithshme e ortakëve emëron një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 14

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.



Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 15 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 16 EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

KREU V PRISHJA —RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 17 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve/Ortaku të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;



Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket/Ortaku.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve/Ortakut të vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 19

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 20

MOSMARRËVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan.

ORTAKU

I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“OLEA TRADE” sh.p.k.

MALERBA ANTONIO

